
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

KONTRATA E NEGOCIUAR

Datë: 23.11.2018

PJESA I E KONTRATËS

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga UÇK-së nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë;
Dhe

"Niti - N" nga Prishtina, adresa: "Lidhja e Prizrenit", me numër të regjistrimit të biznesit 71064727 dhe me numër fiskal 601122716 e përfaqësuar nga Naim Zymeri – drejtor, në tekstin e më tejme ("Ofruesi i shërbimeve"), janë pajtuar për realizimin e shërbimeve – punëve si në vijim:

Mirëmbajtja emergjente dimërore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit LOT 6

Numri i prokurimit: 616 18 149 525

Neni 1 Lënda 1.1 Lënda e kësaj kontrate është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen shërbimeve dhe punëve të mirëmbajtjes në vijim: **Mirëmbajtjen emergjente dimërore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit** specifikimeve teknike detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të përformohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjërin prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të porosisë shërbime më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje sa herë që të prokurojnë punë; të përmendura në 1.1.

1.4 Ofruesi i shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Kontrata hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon në një periudhë prej 2 muajsh.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë nga data 23.11.2018 deri me datën 23.01.2019 prej 2 muajëve.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë në Prishtinë: në rrugët dhe trotualet e cekura për pjesën e dytë në Aneksin 1.

Çmimi

3.1 Çmimi i punëve për mirëmbajtje për tërë sezonën janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve paraqitur nga Kontraktuesi. Çmimi total i punëve është: **31.842,43€; (tri dhjete e nje mije euro te qind e katër dhjete e dy euro e katër dhjete e tre euro cent)**. Qe do te thotë çmimi mujor është 15.921,21 €

3.2 Paguesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën për çdo muaj në bazë të punëve dhe shërbimeve të kryera sipas raportit të Menaxherit/menaxherëve të projektit nga Komuna. Çdo pagesë duhet te aprovohet nga Zyrtari i prokurimit dhe zyrtari i financave te Autoritetit Kontraktues.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike..

3.4 Pagesat do te jene mujore.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata e neogjuar
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 ZKA me nënshkrimin e kësaj kontrate merr përgjegjësinë për sigurimin e mjeteve për pagesë, ndërsa për shqyrtimin e ofertave dhe zgjedhjen e kontraktuesit bazohet në vlerësimin e komisionit profesional, të cilët janë përgjegjës për vlerësimin e kritereve të përzgjedhjes dhe përmbajtjen e ofertave të operatorëve ekonomik.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe në katër origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin
Zekë Bardhaj	Emri:	Naim Zymeri
Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	Dr. Nestor
	Nënshkrimi:	
23.11.2018	Data:	23.11.2018
	Vula:	

PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

PJESA I. FORMULARI I TENDERIT

Për: KK Prishtina

(në vazhdim të tekstit “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i kontratës: **Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve,debllokimi I kanalizimit atmosferik”**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mesiperme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbytjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: < 616 18 149 525 >. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2.. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve,debllokimi I kanalizimit atmosferik”

3. Çmimi total i tenderit është:

1] LOT1

Çmimi i tenderit në shifra: [] shëno

çmimin e tenderit në shifra €]

Dhe në fjalë [] shëno çmimin e

tenderit në fjalë Euro]

LOT 2

Çmimi i tenderit në shifra: [] shëno

çmimin e tenderit në shifra €]

Dhe në fjalë [] shëno çmimin e

tenderit në fjalë Euro]

LOT 3

Çmimi i tenderit në shifra: [] shëno

çmimin e tenderit në shifra €]

Dhe në fjalë [] shëno çmimin e

tenderit në fjalë Euro]

LOT 4

Çmimi i tenderit në shifra: [] shëno

çmimin e tenderit në shifra €]

Dhe në fjalë [_____] shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

LOT 5

Çmimi i tenderit në shifra: [_____] shëno çmimin e tenderit në shifra €]

Dhe në fjalë [_____] shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

LOT 6

Çmimi i tenderit në shifra: [95,827.31 €]

Dhe në fjalë [Nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë pikë tridhjetë e njëEuro/Cent]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej 90 ditëve nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës 10% e vlerës së kontratës.
6. Operatori Ekonomik ["NITI-N SH.P.K dhe "Milenium Konstruktion"] kanë këtë nacionalitet [shqiptarë]
7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [Pjesën e VI-të], me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

[Në rast të konsorciumit]


[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [Pjesën e VI-të] si partner në konsorcium të udhëhequr nga ["Niti-n" sh.p.k]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

Numri i Prokurimit: 616 18 149 525– Titulli: Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve,debllokimi I kanalizimit atmosferik”

E DORËZUAR NGA


IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË ⁴	“NITI-N” SH.P.K
ADRESA E PLOTE	ULPIANA A1-LOK 2A
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	NAIM ZYMERI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	23/11/2018
VULA	

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1*	“Milenium Konstruktion” sh.p.k	Prishtinë
Etj ... *		

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [Naim Zymeri]

Nënshkrimi: 

Vendi dhe data: [Prishtinë, 23/11/2018]

Vula e Udhëheqësit: _____

⁴ Në rast të Grupit të OE emri i liderit të Grupit të OE





Pjesa II. LISTA E ÇMIMEVE
Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit – Pjesa e VI-te

Pjesa e gjashtë (Lloto VI)	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
<p>1 Largimi i borës dhe akullit nga rrugët dhe trotuaret sipas pozicioneve të parapara në specifikimin e aktiviteteve</p> <p>a) Largimi i borës nga rruga;</p> <p>b) Largimi i borës nga trotuari;</p> <p>c) Hedhja e kripës të kombinuar me rërë;</p> <p>d) Hedhja e rërës;</p> <p>h) Mbledhja e mbeturinave nga shportat dhe pastrimi i shportave;</p> <p>Vërejtje: në këtë pozicion duhet të jepet çmimi për të gjitha aktivitetet e parapara sipas specifikimit të aktiviteteve për mirëmbajtjen e një metri katror të rrugës ose trotuarit në ditët kur kemi reshje të borës</p>	m ²	<p>292,880 (m²) x30(ditë) =</p> <p>8,786,400.00</p>	0.0011	9,665.04
<p>2 Mbledhja e mbeturinave, fshirja dhe larja e rrugëve sipas pozicioneve të parapara në specifikimin e aktiviteteve</p> <p>e) Mbledhja e mbeturinave dhe fshirja e rrugëve;</p> <p>f) Larja e rrugëve;</p> <p>g) Pastrimi dhe deblokimi i kanalizimit atmosferik;</p> <p>h) Mbledhja e mbeturinave nga shportat dhe pastrimi i shportave;</p>	m ²	<p>292,880 (m²) x151(ditë) =</p> <p>44,224,880.00</p>	0.0011	48,647.37



Handwritten signature

	Vërejtje: në këtë pozicion duhet të jepet çmimi për të gjitha aktivitetet e parapara sipas specifikimit të aktiviteteve për mirëmbajtjen e një metri katror të rrugës ose trotuarit në ditët kur nuk kemi reshje të borës				
3	Furnizimi, transportimi, matja para organit mbikëqyrës dhe deponimi i kripës.	ton	301.67	115	34,692.05
4	Furnizimi, transportimi dhe deponimi i rërës.	m ³	188.19	15	2,822.85
Totali për pjesën e gjashtë:					95,827.31 €

Identifikim i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i oe:	"NITI-N" SH.P.K
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit te oe:	NAIM ZYMERI
Nënshkrimi:	
Data:	11/23/2018
Vula:	

Handwritten signature